

SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI

n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku

PREDMET: Dostava Izvještaja o stanju imovine Opštine Tuzi za 2019. godinu

NAPOMENA: Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine

PODNOŠILAC PREDMETA: Predsjednik Opštine

OBRAĐIVAČ AKTA: Direkcija za izgradnju, imovinu i zastupanje

PRILOG: Predlog Zaključka

Poštovani,

Na osnovu člana 60 stav 2 Statuta opštine Tuzi („Službeni list CG-opštinski propisi“ br.24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam:

- Predlog Zaključka o prihvatanju Izvještaja o stanju imovine opštine Tuzi za 2019.godinu, sa izvještajem sa javne rasprave radi stavljanja u proceduru Skupštine opštine Tuzi.

Za predstavnicu predlagača koja će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Elvira Redžematović vd Direktorice Direkcije za izgradnju, imovinu i zastupanje.

KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT

Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar

LËNDA: Dorëzimi i Raportit mbi gjendjen e pronës së komunës së Tuzit për vitin 2019

VËREJTJE: Të përfshihen në rendin e ditës në seancën e rrallës së Kuvendit të Komunës

PARASHTRUESI I PROPOZIMIT: Kryetari i Komunës

PËRPUNUESI I AKTIT: Drejtorja për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

SHTOJCË: Propozimi i Konkludimit

I nderuar,

Në bazë të nenit 60 paragrafit 2 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat e komunës” nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj:

- Propozimin e Konkludimit mbi miratimin e Raportit mbi gjendjen e pronës së komunës së Tuzit për vitin 2019, së bashku me Raportin nga debati publike për ti hell në procedurën e Kuvendit të komunës së Tuzit.

Për përfaqësuese të propozuesit e cila do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materiali, përcaktohet Ellvira Rexhematović, u.d. së Drejtoreshës së Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim.

S poštovanjem,

Me respekt,

PREDSJEDNIK – KRYETARI,
Nik Gjelošhaj



**DREJTORIA PËR NDERTIM, PRONË DHE PËRFAQËSIM I
KOMUNËS SË TUZIT**

R A P O R T
MBI GJENDJEN E PRONËS NË KOMUNËN E TUZIT
PËR VITIN 2019.

TUZ, MARS, 2020

Në bazë të nenit 42 dhe nenit 44 të Ligjit mbi pronën shtetërore („Fleta Zyrtare e MZ“, nr.21/09, 40/11), nenit 33 dhe nenit 34 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale („Fleta Zyrtare e Mz“, nr.02/18,34/19), nenit 32 të Statutit të Komunës së Tuzit („Fleta Zyrtare e MZ“, - dispozitat komunale, nr.24/19,05/20), Rregullores mbi mënyrën e udhëheqjes së evidencës së gjërave të tundshme dhe të patundshme dhe me regjistrimin e gjërave në pronësi të shtetit („Fleta Zyrtare e Mz“ – dispozitat komunale, numër 024/19), Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim të Komunës së Tuzit, dorëzon:

R A P O R T

mbi gjendjen e pasurisë së Komunës së Tuzit për vitin 2019.

I Vërejtjet hyrëse

Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim në Komunën e Tuzit ka hartuar Raportin mbi gjendjen e pronës së Komunës së Tuzit për vitin 2019. në pajtim me planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit për vitin 2020.

Neni 42 i Ligjit për Pronë Shtetërore parashikon detyrimin për mbajtjen e një procesverbali unik të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme në dispozicion të Komunës, dhe neni 44 i të njëjtit ligj parashikon që të evidentimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, mbi të cilat të drejtat dhe pronësore e ushtrohen nga komuna, mbahen nga organet komunale që i shfrytëzojnë ato gjëra.

Me nenin 33 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, është paraparë që Komuna ka pasuri, që pasurinë e Komunës e përbëjnë gjërat e luajtshme dhe të paluajtshme të Komunës, mjetet financiare, letrat me vlerë dhe të drejta të tjera pronësore në pajtim me ligjin, përderisa me nenin 34 të të njëjtit ligj është paraparë që komuna disponon, mbron dhe menaxhon me pasurinë e vet në pajtim me qëllimin e tyre, me kujdesin e afaristit të mirë në pajtim me ligjet e veçanta, ku komuna dhe shërbimet publike themelues i të cilave është komuna janë të obliguara të bëjnë evidencën mbi pasurinë e vet, si dhe kjo pasuri të paraqitet në pajtim me ligjin.

Sipas nenit 30 të Statutit të Komunës së Tuzit, është paraparë që pasurinë e përbëjnë gjërat e lëvizshme dhe të palëvizshme, para, letra me vlerë dhe të drejta të tjera pronësore, në përputhje me ligjin, që prona e Komunës së Tuzit të disponohet nga Kuvendi i Komunës

së Tuzit, përveç në rastet e tjetërsimit të të drejtave të pronës mbi pasuritë e paluajtshme me kontratë të drejtpërdrejtë të vendosur me ligjin që rregullon pronën shtetërore, që Kuvendi i Komunës së Tuzit të mund të transferojë të drejtën dhënies me qira të pasurisë dhe të drejtën për të shitur prona të luajtshme organeve kompetente të administratës së Administratës së Tuzit, në përputhje me një vendim të posaçëm.

Në nenin 32 të Statutit të Komunës së Tuzit parashikohet që Komuna e Tuzit dhe shërbimet publike të krijuara nga Komuna janë të detyruara të mbajnë evidentimin e pasurisë së tyre në përputhje me ligjin, të përgatisin rregullore dhe akte të tjera, kryerjen e procedurave, përgatitjen e akteve individuale në fushën e asgjësimit, menaxhimit dhe përdorimit të pronës shtetërore; mbrojtja e pronave dhe interesave juridike të Komunës së Tuzit, si dhe vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme në dispozicion të Komunës së Tuzit, që kryhet nga organi i administratës komunale kompetent për çështjet e pronës, që prona e Komunës së Tuzit të raportohet në përputhje me ligjin, dhe se Kuvendi do të marrë në shqyrtim raportin e statusit të pasurisë së komunës dhe shërbimeve publike, të paktën një herë në vit.

Me nenin 12 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e menaxhimit të administratës lokale të Komunës së Tuzit parashikohet që Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim, ndër të tjera, kryen detyra administrative që kanë të bëjnë me detyra administrative dhe profesionale që lidhen me të drejtat e pronës dhe autorizimet për pronën në dispozicion të saj dhe të përdorura nga Komuna dhe organet e saj, mbajtjen e evidencës për ato pasuri dhe raportimin për gjendjen e pasurisë.

Të drejtat e pasurisë mbi gjërat dhe të mirat e tjera në pronësi shtetërore do të ushtrohen në përputhje me Ligjin për pronën shtetërore dhe në atë mënyrë që siguron transparencën. Organet kompetente janë të detyruara t'i trajtojnë gjërat dhe pasuritë e tjera në pronësi shtetërore dhe me pasurinë me të cilën disponon Komuna të veprojnë si kujdestar të mirë dhe të jenë përgjegjës për të. Dispozitat e Ligjit mbi pronën shtetërore përcaktojnë se pronari i gjërave në pronësi shtetërore është Mali i Zi, ndërsa disa autorizime të pronësisë mbi pronën shtetërore i ushtrojnë komunat në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj. Autorizimet pronësore mbi gjërat në pronësi shtetërore kryhen edhe nga subjekte të tjera: organe shtetërore, organe të vetëqeverisjes lokale dhe shërbimeve publike themelues i të cilave është Mali i Zi, gjegjësisht vetëqeverisja lokale dhe organet e tjera dhe organizatat të cilat i shfrytëzojnë mjetet e buxhetit ose menaxhojnë me pronën shtetërore, në pajtim me ligjin ose me rregullore të tjera të sjellura në bazë të ligjit.

Me aktet nënligjore të sjellura në bazë të Ligjit mbi pronën shtetërore dhe atë: Me rregullore mbi mënyrën e menaxhimit të evidencës së gjërave të lëvizshme dhe të palëvizshme dhe mbi regjistrimin e gjërave në pronësi shtetërore dhe me Udhëzimin mbi mënyrën e hollësishme të kryerjes së regjistrimeve të gjërave të lëvizshme dhe të palëvizshme në pronësi shtetërore, hollësisht është rregulluar detyrimi, procedura dhe formularët e paraparë për evidentimin e gjërave në pronësi të shtetit.

II Evidentimi dhe menaxhimi me pasurinë komunale

Gjërat e lëvizshme dhe të palëvizshme, mjetet monetare dhe të drejta të tjera pronësore në pajtim me ligjin e përbëjnë pasurinë e Komunës së Tuzit. Komuna e Tuzit dhe organet kompetente janë të obliguar që ligjërisht dhe ekonomikisht të menaxhojnë dhe të shfrytëzojnë gjërat dhe të mirat e tjera në pronësi të shtetit në pajtim me Ligjin mbi pasurinë shtetërore.

Përveç pasurive natyrore dhe të mirave në përdorim të përgjithshëm të cilat nuk mund të jenë objekt i pasurisë private, të drejtat pronësore në gjëra dhe të mirat e tjera në pronësi shtetërore janë në qarkullim. Me pasurinë shtetërore menaxhon organi kompetent për punët e pasurisë, përderisa me pasurinë komunale menaxhojnë organet e administratës lokale dhe shërbimet publike (institucionet publike dhe shoqëritë afariste themelues i të cilave është komuna) të cilave pasuria e Komunës së Tuzit u është dhënë në menaxhim.

Mbi disponueshmerinë me pasurinë shtetërore vendos Qeveria e Malit të Zi, derisa mbi gjërat dhe të mirat e tjera me të cilat disponon Komuna e Tuzit, vendosin organet kompetente në pajtim me Statutin e Kuvendin e Komunës së Tuzit.

Komuna e Tuzit dhe shoqëritë afariste themelues i të cilave është, bëjnë evidentimin mbi pasurinë e tyre, e cila trajtohet në veçanti për gjërat e lëvizshme dhe të palëvizshme.

Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim në pajtim me ligjin dhe kompetencat e veta ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet që të kryejnë evidentimin e pasurisë së Komunës së Tuzit, në mënyrë që ka lajmëruar të gjitha organet dhe shërbimet e Komunës së Tuzit dhe shoqërinë afariste themelues i të cilave është të bënë regjistrimin e pasurisë së lëvizshme dhe të palëvizshme dhe atë në formularët e paraparë me ligj. Pas dorëzimit të listave të regjistrimit, Drejtoria në afatin e paraparë i është qasur hartimit të Raportit mbi gjendjen e pasurisë së Komunës së Tuzit për vitin 2019.

III Të dhëna mbi pasurinë e lëvizshme

Të dhënat për pronat e lëvizshme në përdorim nga organet e qeverisjes lokale dhe shoqëritë afariste të themeluara nga Komuna Tuzit paraqiten në bazë të regjistrimit të plotë të datës 31.12.2019. sipas listës dhe regjistrave të kontabilitetit, të cilën e kanë dorëzuar të emëruarit në vazhdimësi deri në fund të muajit mars të vitit aktual.

Në bazë të të dhënave të dorëzuara është përcaktuar që vlera totale e pasurisë së Komunës së Tuzit është: 145.192.08 euro.

Vlera totale e pajisjeve të mobileve të zyrave dhe inventarit të imët është: 75.356,48 euro.

Vlera totale e mjeteve të transportit është: 69.835,6 euro.

IV Të dhënat mbi pasurinë e palëvizshme

Me datën 31.12.2019., Komuna e Tuzit nuk ka të evidentuara gjëra të palëvizshme në pronësi të vet, duke pasur parasysh faktin se nuk është kryer procesi i ndarjes së pasurisë dhe përcaktimi i kufijve kadastral mes Komunës së Tuzit dhe Kryeqytetit Podgoricës.

V Vërejtjet përfundimtare

Me përfundim të procedurës së caktimit të kufijve dhe ndarjes së pasurisë mes Komunës së Tuzit dhe kryeqytetit Podgoricës, Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim, në pajtim me ligjin, do të fillojë punët që kanë të bëjnë me formimin dhe udhëheqjen e regjistrimit të patundshmërive, regjistrimit të patundshmërive në Komunë si dhe implementimin e udhëzimeve nga Plani Aksionar të Qeverisë mbi ndarjen e pasurisë shtetëror prej asaj komunale.

Numër: 09-032/20-2693

Tuz, 12.03.2020

U.D. DREJTORE,

Ellysa Rexhematoviq



Në bazë të nenit 130 të Rregullores së punës së Kuvendit të komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale" nr. 29/19), Kuvendi i komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më _____, 2020, duke shqyrtuar Raportin mbi gjendjen e pronës së komunës së Tuzit për vitin 2019, ka sjell

KONKLUDIM

mbi miratimin e Raportit mbi gjendjen e pronës së komunës së Tuzit për vitin 2019

1. Miratohet Raportit mbi gjendjen e pronës së komunës së Tuzit për vitin 2019.
2. Ky konkludim do të publikohet në "Fletën zyrtare të MZ - dispozitat komunale".

Numër: 02-030/20-
Tuz, _____, 2020. godine

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT
KRYETARI,
Fadil Kajoshaj